

Volta

...tani kur po bie nuzgu...

Diell mbretëror, i përskuqur, një monedhë e mrekullueshme e ditës,
kur më prek, lëkura ime bëhet kornë,
shpina ime nerv optik, e trupi drithërohet
i hutuar nga vrushkujt e artë me të cilat
e spërkat detin dhe qytetin, jam verbuar.
Vallë, s'paska pasur këtu – mbase ka pasur –
vargje shtëpish dhe rrugësh, prona të një qyteti tjetër,
e jo të këtij që ti e ndryshove me rrënjë?

Shëtisim breg liqenit. Barkat e vogla
të peshkatarëve të natës janë gati të lundrojnë,
motorët gumëzhijnë, llambat parafine ndriçojnë
mbi kulmar, qyteti i tërë ka dalë shëtitje –
të dashuruarit dorë për dorë, të rinjtë,
etërit dhe nënat, fëmijët lëpijnë akulllore,
të moshuarit vështrojnë nga kafe-baret e trotuareve,
e kodrat pa dritë afrohen gjithnjë e më afër,
sikur të ishin bisha të zbutura.

Një përskuqje e ëmbël qiellore, e shpërndarë mbi kodra e brigje,
dora jote ledhaton timen, si pa dashje,
si prekja e gruas së re që kalon pranë meje,
me vithe të kolme, hapa të imët e ecje gracioze,
me leshrat hedhur prapa, gushën skofiare dhe supat
bronze vere, e sytë e qeshur bojë kafe ulliri.
Të pi ty, o shkëlqim drithërues, si të ishe verë, muzikë,
siç të pinin të parët me shekuj.

Qytet vezullor, emri i saj është Elefteria,
pra, edhe pse vragët e tua janë njolla të murrme në sytë e saj,
përsëri, në këtë çast kur shkëlqimi dhe shpërndarja e tij
vallëzojnë lehtas mbi fytyrën e saj, si të ishin fjalë e këngë,
asaj i takon e drejta e motit, të shëtisë nëpër këtë port
si të ishte vegël dhe roje e shkëlqimit tënd
e cila zhytet në pusët e thellë të bebëzave tua,
kurse, liria e saj e dashur, kërcen si valltare.

O muzgu i dashur, dritë mijëvjeçare,
këngëtari me të njëjtin zë, i veçantë posi kjo vashë,
si të mos mahnitim me mëshirën që i fal
këtij qyteti dhe njerëzve të tij, skulptor

i cili formëson çdo gjë që prek, botën mbarë?
U shndërrova në robin e tij, kur nuk jam më banori yt.
Dhe, duke u përmallur të të pi me fund,
po e vadis çdo pore të rrezes tënde, të lirisë tënde.

Richard Berengarten

Përktheu / translated by Resul Shabani

interLitQ.org